



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 35, datë 30.03.2017

PËR

**MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË “SIGMA INTERALBANIAN” VIG SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, të Z. Artur Tafa, Z. Bledar Keçi, Zj. Brisilda Hyseni, Z. Ermal Shehu, Zj. Frida Draçi, Z. Gentian Grabova, Z. Masimo Lazri, Zj. Zamira Zdrava dhe Z. Artur Shehu, në emër dhe për llogari të shoqërisë të sigurimit “Sigma Interalbanian” VIG sh.a.
2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI